



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr.60, datë 25.07.2016

Për

**“ DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR PËRBALLIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA
NGA FATKEQËSITË E
NDRYSHME NATYRORE PËR DISA FAMILJE TË TIRANËS”.**

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 29, pika 1 dhe nenin 55, pika 1, të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 2 pika 4 dhe nenit 32 të ligjit nr.8756, datë 26.03.2001 për “Emergjencat civile” (i ndryshuar); të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.329, datë 16.5.2012 për “Kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr.58, datë 30.12.2015, për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016 – 2018 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2016”(i ndryshuar) me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. T’i akordojë një ndihmë financiare familjeve të cilave ju është dëmtuar banesa dhe orenditë shtëpiake nga zjarri / përmbytja si më poshtë:
 - a. Për familjen e z. Musa Hamdi Dajti, shuma **261.800** (*dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e tetëqind lekë*).
 - b. Për familjen e z.Xhemal Ibrahim Lami **149.450** (*njëqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind e pesëdhjetë lekë*).
 - c. Për familjen e z. Prenç Elez Prençaj **800.000** (*tetëqind mijë*) lekë.
 - d. Për familjen e z. Renis Reshit Hoxha **117.000** (*njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë*) lekë.
2. Efektet financiare të pikës 1 të këtij vendimi të përballohen nga fondi i emergjencave i parashikuar në Buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2016.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Emergjencave Civile.

4. Ky vendim në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI